



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimi / Dorezuar Primijsenja/Prodato Received/Delivary	25-05-2022	viti god year	2
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
BKIMSHOK	3029/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.360/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga Eshref Shabani, kryetar, Malsore Gashi – Bajraktari dhe Jeton Koca -anëtarë, me Rusht Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.360/2022 të datës 13.04.2022, të parashtruar nga ankuesi me adrese banimi: nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Zhvillimit Rajonal, ne çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 25.05.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A. Nr. 360/2022 e datës 13.04.2022, e parashtruar nga ankuesi

II.MBETET në fuqi, Vendimi i datës 11.03.2022 me numër:315 si dhe vendimi i datës 22.03.2022 me numër protokolli:442 i Zv. Drejtoreshës së DFSHP/MZHR.

A r s y e t i m

Ankuesi ka aplikuar për pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin e Politikave” të publikuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal në konkursin e datës 14.02.2022, ndërsa Njësia e Burimeve Njerëz e Ministrisë së Zhvillimit Rajonal përmes vendimit me numër:315 të datës 11.03.2022 i ka refuzuar aplikacionin për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të konkursit.

I pakënaqur me vendimin për refuzim të aplikacioni, ankuesi me datë 16.03.2022 ka parashtruar ankesë në Njësinë e Burimeve Njerëzore, ndërsa të njëjtit përmes vendimit të datës 22.03.2022 me numër protokolli:442 të nxjerrë nga Zv. Drejtoresha e DFSHP/MZHR e kanë refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi me datë 13.04.2022 me numër protokolli 2042/2022 ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit të datës 22.03.2022 me numër



protokoli:442 të nxjerrë nga Zv. Drejtoresha e DFSHP/MZHR me pretendimet ankimore së konkursi duhet të anulohet për shkak të shkeljes së Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ngase ka shkelje flagrante lidhur me përcaktimin e kriterëve të konkursit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave, me datë 15.04.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Zhvillimit Rajonal. Ndërsa me datë 18.04.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, pas konstatimit së ankesa është e pranueshme sipas nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 306/2022, e datës 13.04.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkursi i datës 03.02.2022; Konkursi i datës 10.09.2019; Konkursi i datës 14.02.2022; Konkursi i datës 19.01.2021; Konkursi i datës 23.11.2021; Vendimi i datës 11.03.2022; Ankesë e datës 16.03.2022, drejtuar Njësisë se Burimeve Njerëzore; Vendimi i datës 22.03.2022, me numër 442; Vendimi i datës 16.03.2022, për themelimin e Komisionit për vlerësimin për ngritje në detyrë; Njoftimi i datës 11.03.2022; Njoftimi i datës 22.03.2022; Kërkesë për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 386, e datës 09.11.2006; diplomë e datës 10.03.2015; Akt Emërimi i datës 16.10.2018; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2021, për ankuesin Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2020, për ankuesin Mirënjohje e datës 31.12.2020; Certifikatë e datës 24-25, e muajt shtator të viti 2020; Certifikatë e muajt dhjetor të vitit 2018; Akt Emërimi i datës 16.10.2018; Vërtetimi i datës 01.01.2016; Marrëveshje shërbime të veçanta e datës 14.05.2014; Kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; Diplomë e datës 15.08.2021; Certifikatë e datës 15.07.2021; Akt Emërimi i datës 05.08.2018; Certifikatë e datës 16.12.2021; Certifikatë e datës 12.06.2019; Certifikatë e datës 24.07.2019; Vërtetimi i datës 15.05.2018; Marrëveshje shërbime të veçanta e datës 15.12.2017; Ankesë marrëveshja e datës 16.03.2018; Vendim i datës 02.08.2021; Vendimi i datës 01.02.2022; Formuari për vlerësimin e rezultateve në punë, për vitin 2020, për Përgjigje në ankesë e datës 26.04.2022, me numër protokoli 2392/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e pa bazuar sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar së në konkursin e shpallur 14.02.2022 për pozitën: Drejtues i Ulët 1- "Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin e Politikave" nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, kriteret e konkursit kanë qenë:

- *Arsimi i kërkuar; Diplome Universitare; në drejtimin Juridik, Ekonomik, Shkenca Politike me të paktën 240, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to, dhe*
- *Se paku (5) vite përvojë pune profesionale.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave më qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore ka analizuar dispozitat e Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës neni 53 paragrafi 1 dhe 4 ku përcaktohet se: "Për të aplikuar për ngritjen në detyrë, personi duhet të plotësojë së bashku, kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet; 4. Kërkesat e veçanta për pozitën e lirë përcaktohen sipas përshkrimit të punës dhe bëhen pjesë e shpalljes për ngritjen në detyrë" si dhe nenin 55 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe 3.7 ku përcaktohet se: "Shpallja për konkurrim bëhet nga NJBNJ dhe përmban të paktën këto të dhëna: 3.3 kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e posaçme për pozitën e lirë; 3.7 fushën e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen", ndërsa në shkresat e bashkangjitura të lëndës të ofruara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal është ofruara në cilësi të provës edhe e-maili i datës 08.03.2022 me titull "opinion ligjor" dërguar nga zyrtari i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik (DMZP)/MPB, ku ndër të tjerash thuhet, citoj: "... kur

bëhet fjalë për çështjen e konkursit për plotësimin e vendeve të punës "Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave" konkurrentët adekuat për këtë vend punë janë, siç e keni cekur edhe ju ata me fusha të studimit në; Ekonomik, Juridik dhe Shkenca Politike", andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se konkursi lidhur me pozitën e kontestuar është hapur në pajtueshmëri dispozitat e Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Ngritja në detyrë realizohet nëpërmjet një procedure konkurruese të organizuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit, që ka pozitën e lirë".

Ndërsa në bazë të shkresave të lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesi ka të kryer Fakultetin Filozofik i cili ka marr titullim Bachelor i Filozofisë dhe ka diplomuar me datë 09.10.2006, si dhe në bazë të diplomës së datës 20.03.2015 ka të kryer Fakultetin Filozofik-Departamenti i Sociologjisë dhe ka marr titullin "Master i Sociologjisë", andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se refuzimi i aplikacionit të ankuesit nga Njësia e Burimeve Njerëzore është bërë në pajtueshmëri me dispozitat e Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, neni 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 ku përcaktohet se: "1. Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2. Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3. Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë" pasi që ankuesi nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit lidhur me fushën e arsimimit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin e Politikave" e shpallur sipas konkursit të datës 14.02.2022, i publikuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon së në konkursin e datës 03.02.2020, si dhe në konkursin e datës 10.09.2019 të publikuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, kriteret apo kushtet përcaktuara kanë qenë të ndryshëm dhe të përfshira edhe kriteret e arsimimit nga shkencat shoqërore, Kolegji sjellë në vëmendje se Ligji Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik është i zbatueshëm nga data 09.07.2020 sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese Nr.ref.1583/20 të datës 09.07.2020, rrjedhimisht konkurset e datës 03.02.2020 dhe 10.09.2019 janë shpallur mbi bazën e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj, ndërsa çështja e rekrutimit sikurse konkursi apo ngritja në detyrë dhe avancimi, tani janë përcaktuar ndryshe me Ligjin Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik qoftë në aspektin e procedurave apo të kriterëve dhe kushteve relevante, andaj mbi këtë bazë pretendimet e ankuesit janë të paqëndrueshme dhe nuk mund të përdoren si analogji argumentuese në rastin konkret.

Andaj, mbi bazën e shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe mbështetur në arsyetimin e pasqyruar si më lartë në këtë vendim, Kolegje konstaton se Njësia e Burimeve njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit përmes vendimit të datës 11.03.2022 me numër 315 si dhe refuzimit të ankesës së ankuesit përmes vendimit të datës 22.03.2022 me numër protokolli:442 të nxjerrë nga Zv. Drejtoresha e DFSHP/MZHR ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 15 paragrafi 5 dhe 6 të Rregullores (QRK) nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: "5. Kandidatë, që nuk plotësojnë kushtet për aplikim në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se katermbëdhjetë (14) ditë kalendarike nga data përfundimtare e pranimit të aplikacioneve. 6. Brenda tre (3) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë Njesisë Përgjegjëse. Ankesa shqyrtohet nga Njësia Përgjegjëse e cila me vendim e njofton kandidatin brenda pesë (5) ditëve nga paraqitja e saj" si dhe në pajtueshmëri edhe me nenin 39 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: "Mund të aplikojnë për ngritje në detyrë, sipas paragrafit 1 të këtij neni, vetëm nëpunësit civilë të një kategorie më të ulët, në marrëdhënie pune në të njëjtin apo në çdo institucion tjetër të Shërbimit Civil, nëse plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Në procedurën e

ngritjes në detyrë në kategorinë e ulët drejtuese mund të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të kategorisë profesionale të konfirmuar sipas nenit 37 të këtij ligji”, andaj mbi këtë bazë ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar ndërsa vendimi i datës 11.03.2022 me numër 315 dhe vendimi i datës 22.03.2022 me numër protokolli:442: i Zv. Drejtoreshës së DFSHP/MZHR mbetën në fuqi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 360/2022

Rushit KAJTAZI
[Signature]
Procesmbajtës

Eshref SHABANI
[Signature]
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.